

INAJET SHEHU

# INSPEKTIMI

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

SH-7  
SH 69.

NOVELË



81H-37  
            
5429.

INAJET SHEHU

# INSPEKTIMI

Novelë satirike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

*Kjo novelë fitoi çmimin e dytë në konkursin  
e 30 vjetorit të krijimit të Ushtrisë Popullore.*

**Redaktor: Moisi Zaloshnja**

**Piktor: Bardhyl Fico**

---

Tirazhi: 5000 kopje · Format : 70 x 100/32      Stash. 2204-72

---

Shtypur: Drejtoria Qendrore e Poligrafisë  
Shtypshkronja «MIHAL DURI» — Tiranë, 1974




## KREU I

Zereni, një vend i humbur diku në skajin verior të mbretërisë, megjithëse ishte qendër nënprefekturë dhe nga banorët e tij quhej qytet, në fakt nuk ishte i tillë. Atje kishte mbi dyqint e ca shtëpi. dy xhami, një kafene, një berberhane e një opingar. Përveç këtyre kishte edhe një rrethkomandë xhandarmërie dhe një alamet reparti ushtarak. Por një ditë prej ditësh, edhe reparti ushtarak, i cili i jepte njëfarë gjallërie, u dislokua diku në një vend tjetër dhe Zereni mbeti si një fshat i madh. Pra a mund të quhej qytet një vend i tillë, për hir të dy xhamive, kur me largimin e repartit ushtarak ai humbi edhe atë pak gjallëri që i jepnin çdo mbrëmje ushtarët e Lartmadhërisë së Tij?! Në asnjë mënyrë. Një kompani ushtarësh, që mbeti në Zeren, dhe që nuk kishin asnjë armatim tjetër me përjashtim të pushkëve, nuk mund t'ia ndryshonte aspak zyntinë një vendi të humbur siç ishte ajo qendër nënprefekturë.

Për çudi, megjithëse reparti u transferua me kuç e me maç, komandantin e tij, një nga komandantët më në zë të Lartmadhërisë, majorin Mahmut Beshi, nuk e lëvizën që andej. Nën vartësi i lanë to-





1. The man in the uniform is the main character of the story.

ger Jahjen, me detyrë shef shtabi, nëntoger Estrefin, komandant kompanie dhe kapter Kaleshin, i ngarkuar me magazinën ushqimore të repartit.

Major Beshi nuk e mori vesh se si ngjau një punë e tillë. Nga komandant reparti me qindra ushtarë e dhjetëra oficerë, që përbënin dikur shtabin e tij, kishte përfunduar në një komandant me nja tridhjetë e ca ushtarë, dy oficerë e një kapter. Komandant i thënçin!

I thoshte mendja se për këtë ndryshim patjetër do të kishte patur ndonjë keqkuptim, prandaj edhe i shkroi shkëlqesisë së tij, gjeneral Aranitasit. Por ky s'u bë i gjallë fare, thua se major Beshi, gjer në atë kohë kuadër me rëndësi i ushtrisë famëmadhe mbretërore, të mos ekzistonte fare në atë mbretëri. Një mospërfillje e tillë nga ana e eprorëve të tij, në fillim e tërboi, por me kalimin e kohës, plaga filloi t'i zinte kore. Bile, po ta mendoje hollë-hollë më mirë që punët kishin marrë këtë udhë. Rehat ishte sa s'kishte ku të shkonte. Nga krahina ku kishte lindur nuk e lëvizën dhe napolonat po i merrte ashtu siç i merrte edhe më parë. E ç'të kërkonte tjetër nga Lartmadhëria zemërgjerë?

Sidomos kjo puna e napolonave kishte rëndësi të madhe për major Beshin. E gjithë puna ishte që të mos prekej puna e napolonave, pasi për to linte kokën Mahmut Beshi. Në këtë drejtim ia kishte këputur kokën të atit, dikur një bej i pasur fshati. Atëherë rridhnin napolonat varda. Mirpo i ati shkoi e vdiq taman në një kohë kur Beshi ishte ende i vogël dhe pasuria e tij u bë rrush e kumbulla nga të tjerët. Kur u rrit Beshi e si pa që gjithçka kishte marrë të tatëpjetën, me ato para që kishte ruajtur e ëma për ditë të zezë, vajti e u zuri derën disa miq-



ve e të njohurve të të atit. Dhe, falë kujdesit të tyre e napolonave që u shpërndau, mundi të hynte në një repart ushtarak me gradën aspirant i ushtrisë mbretërore. Kur arriti të merrte gradën e togerit vendosi që të shiste edhe kullat e çiflikut të dikurshëm dhe t'i kushtohej përfundimisht karrierës ush-





tarake. Napolonat tregonin gjendjen shpirtërore të major Beshit. Kur e kishte xhepin plot fytyra e tij ishte shend e verë, kur xhepat i kishte të boshatisur bëhej sterrë fare.

Sa për punët, ato shkolin për birinxhi në repartin e vogël, që drejtonte, gjynah të qahej. Përrjashto stërvitjen, e cila nuk kishte asnjë rëndësi në ato ditë paqeje e lumturie të pashoqe, të garantuara për jetë nga Lartmadhëria e tij, Ahmet Zogu, të gjitha veprimet e tjera kryheshin në mënyrën më të përsosur. Të tre vaftet hareshin në orën e caktuar (hareshin apo nuk hareshin kjo nuk kishte fort rëndësi mjaft që binte çanga për këtë punë) gjumi fillonte kur ta ndienin qepallat.

Fytyrat e thara koskë e lëkurë të ushtarëve, tregonin më së miri merakun që ata kishin për mbrojtjen e pushtetit të mbretit august. Kishte gojë që flisnin se fytyrat e tyre thaheshin nga të pangrënët, por këto ishin gojë rebelësh, të cilët nuk e shikonin me sy të mirë mbretin dhe ushtinë e tij.

Jeta ushtarake në repartin e Zerenit ecte e qetë, pa telashe që mund t'u nxirrnin avaze. Mirëpo i gjithë ky rehatllëk, një ditë prej ditësh mori fund. Shkaktar për këtë prishje qetësie të repartit u bë një fonogram i ardhur papritur nga Ministria e Luftës, poshtë të cilit ishte vetë emri i gjeneral Aranitashit. Ky fonogram ra mbi major Beshin si ajo rrufeja në një ditë të kthjellët e plot diell.

## KREU II

Atë ditë që merr udhë tregimi ynë, major Beshi kishte vënë faqoren me raki dhe një alamet kuti konserve mbi tavolinë, dhe po bënte qejf. Në këtë kohë ndjeu një të trokitur në derë. Fuqi me rrëmbim ato që kishte përpara në kasafortën ku më parë mbante dokumentat, u ra me pëllëmbë mustaqeve të ndotura dhe pastaj thirri:

— Hajde!

Në zyrë, me fytyrë të prishur e të alarmuar dhe me një letër në dorë, u fut Sala, centralisti i reparitit. Kur vështroi çehren e tij të prishur e sidomos atë letër që e shtërngonte fort në dorë, si të kishte frikë se mos i fluturonte, major Beshi mendoi: «A thua përsëri të ketë ndonjë të vdekur në familje, ky qafir dhe tani më vjen në zyrë me buzët varur pesë pëllëmbë e me telegram në dorë që të më kërkojë lejë si zakonisht?» Dhe kishte të drejtë të mendonte kështu majori i squar sepse çdo dy-tre muaj, centralist Salës do t'i vinte patjetër ndonjë telegram, me një përmbajtje pak a shumë të tillë: «Gjyshi u nis për në atë dynja. Qofshi vetë». Ose: «Dulla na la. Të presim për ta kallë në dhe». Ose «Qazimeja





ka tri ditë që mundohet të japë shpirt, të kërkon çdo orë e dekimë». Vetëm herën e fundit, para ndonjë muaji, i kishte ardhur i vetmi telegram me përmbajte gazmore, qysh kur ishte mobilizuar në ushtrinë mbretërore. Në atë telegram i shkruanin «Lopa bëri viç. Hajde sa më parë!» Dhe ja tani një tjetër telegram. Përmbajtja e tij ishte më se e qartë për major Beshin, sepse atë e tregonte vetë çerhja karapuc e Salës. Natyrisht, Salën këto lloj telegramesh e pikëllonin, kurse major Beshin, megjithëse përpiquej të tregohej sikur i vinte keq, e gëzonin. E gëzonin, meqë sa herë kthehej nga këto lejë vdekjeje (dhe këto bajagi ishin mjaft të shpeshta) Sala do t'i sillte komandantit të tij pjesën që i takonte nga darka e shtruar me atë rast: Herë ndonjë pulë, herë ndonjë shishe me raki dhe herë ndonjë shportë të mbushur me vezë. Kjo ishte arsyeja që e detyronte major Beshin që pas çdo telegrami të tillë t'i jepte lejë pa një, pa dy. Me sa dukej, fati po i ndihte majorit me këtë ushtar, njerëzit e të cilit, me sa dukej kishin lidhur ndonjë kontratë me allahun që të shkonin në dynjanë e përtejme varg, njëri pas tjetrit, sa kohë që Sala i tyre po kryente shërbimin ushtarak.

— Hë, qafir, ç'është? — iu drejtua me një notë të theksuar dhembshurie Beshi. Përherë kur ishte në gjendje të mirë shpirtërore, majori u drejtohej të tjerëve me fjalën «qafir», si fjalë përkëdhelëse.

Salë centralisti puliti dy-tri herë qepallat, tërhoqi hundët fort «mundohet që t'i shpërthejë lotët me zor, qafiri!» mendoi Beshi dhe pa e hapur gojën fare, vendosi mbi tavolinë copën e letrës që mbante në dorë. Beshi nuk i hodhi sytë fare nga telegrami që i vuri Sala përpara, por vështroi me një farë keqardhjeje fytyrën e tij. Mendja po i thoshte





se ai telegram duhej të kishte pak a shumë një përmbajtje të tillë: «Filani pret me padurim ardhjen tënde, që të shkojë i lumtur në atë dynja». Duke menduar këtë tekst, Beshit i vajti mendja edhe të shporta me vezë që do t'i sillte Salë centralisti ditën që do të kthehej nga leja. Dhe ky telegram kishte arritur në rastin më kritik. për majorin, sepse Lulushe hanëmi, e shoqja, kishte dy ditë që grindej se në shtëpinë e tyre nuk gjendej asnjë kokërr vezë. I shkëputi sytë nga fytyra e murrëtyer e Salës dhe vendosi t'i hidhte mbi telegramin, që prehej mbi tavolinë, që të provonte fantazinë e tij mbi përmbajtjen e vërtetë të telegramit. I hodhi, pra, sytë mbi atë copë letër sa një fletë fletoreje, dhe, si i endi një copë herë të mirë mbi të gjersa i lidhi shkronjat me njëra-tjetrën, u axi në fytyrë më keq se Sala. Vështroi tërë inat ushtarin, që vazhdonte të qëndronte gatitu para tij, dhe pastaj edhe një herë telegramin që e bëri pikë e vrer. Në fakt, ai nuk kishte qënë telegram me ndonjë përmbajtje siç e kishte menduar Beshi, por një fonogram, një fonogram i tmerrshëm, mbi të cilin Beshi mezi mundi të lexonte këto fjalë:

«JU NJOFTOJMË SE MË DATËN TETË  
TË MUAJIT NË VIJIM PRESJE NË  
REPARTIN TUAJ VJEN INSPEKTIMI  
NGA MINISTRIA PIKË MERRNI MENJË-  
HERË TË GJITHA MASAT E NEVOJSHME  
PËR KËTË DITË TË SHËNUAR PIKË»

Beshi u trondit gjer në themel nga një përmbajtje e tillë. Çfarë mendoi e çfarë i doli! I numëroi një e nga një fjalët e atij fonogrami. I dolën



njëzetenjë të tilla. Njëzetenjë fjalë të vetme, efektin e të cilave nuk do ta bënte as telegrami apo fonogrami që do ta njoftonte edhe për vdekjen e vetë Lartmadhërisë së Tij. U ngrit me rrëmbim dhe gjithë nerva filloi t'i vinte zyrës vërdallë. Nga hapat e tij të rëndë e nervozë, dyshemeja prej dërrase filloi të tundej si të ishte një urë me tela.

«Ku dreqin u kujtuan me këtë inspektim tani?» mendoi. «Sikur kam pak hallet e mija, na tani edhe këta kapadainjtë e ministrisë duan... Si u kujtuan xhanëm edhe për këtë repartin tim në qoshe të dynjasë që e gjetshin prej allahut, e gjetshin! Tphu!» Pështyu pastaj me inat në dyshemenë tërë pluhur dhe vajti e nxori faqoren nga kasaforta. E tërhoqi për disa sekonda pa e shkëputur fare nga buzët dhe pasi shtrëmbëroi fytyrën, i foli Salës që kishte ngri-rë kallkan:

— Dëgjo ti, i ke shkruar mirë këto fjalë, apo jo? Se për nur të allahut, që është një e dy s'bëhet, dhe kur të qaj Lartmadhërinë e Tij, po e pate shkruar gabim, të piu e zeza, të piu!

— Si urdhëron, zotni major Beshi!

— Je i bindur, rrufjan?

— Si urdhëron, zotni major Beshi!

— Mati mirë fjalët, se për nur të allahut, që është një e dy s'bëhet, dhe kur të qaj Lartmadhërinë e Tij... — i bëri kërcënimin e dytë Beshi, duke mos ditur si ta përfundonte.

— Siur...

— ... të var, kërkl!.. Në litar!

— ... dhëron, zotni major Beshi! — vazhdoi Sala aty ku ia këputi fjalën komandanti i tij.

— Hiqmu sysh, qafir! — thirri me sa pat në kokë Beshi.





Salë centralisti përplasi thembrat fort dhe me dorën e shtrirë poshtë strehës së kapeles, doli me hap parade. Ai përplasi derën fort pas vetes, kurse në dorën e majorit u dëgjua zhurma që bëri heqja e tapës së faqores, e cila preku menjëherë buzët e bëra shkrumb. Si ndjeu se në gurmaz nuk po i kalonte asnjë pikë nga ajo e bekuar, e përplasi faqoren gjithë inat pas dyshemesë. Pastaj, si padashur, sytë i vajtën te fonogrami që vazhdonte të qëndronte sipër tavolinës, dhe që ai, për çudi, e kishte harruar. E lexoi një herë, dy ... pesë ... dhjetë ... Gjithçka ishte më se e qartë. Natyrisht, po të ishte shkruar në rregull nga ai rrufjani, Sala. E sa për këtë kot që dyshonte majori i nderuar. Sala ishte i vetmi ushtar i atij reparti që kishte arritur të kryente katër klasë shkollë. Domethënë edhe dy klasë më tepër se major Beshi. Majorit i kujtohej mirë ajo ditë kur i kishin ardhur ushtarët e rinj. I kishin rrjeshtuar të gjithë te sheshi i repartit dhe pas një fjalimi historik të tij, kishte pyetur se cili nga ushtarët dinte shkrim e këndim.

— Unë di, zotni komandant, — kishte kërcyer Sala.

— E sa klasë ke bërë ti, qafir? — E kishte pyetur major Beshi duke iu avitur.

— Katër klasë, zotni komandant!

— Rrudh gojën, qafir i qafirëve! — kishte kërcyer major Beshi si ta kishte kafshuar gjarpëri. — Katër klasë shkollë nuk kam unë që kam gjithë këto grada majori, e jo më të kesh ti, një copë ushtar! Po të kishe bërë aq shkollë sa të thotë ajo rradake, nuk do të kishe ardhur ushtar, po kushedi se çfarë do të ishe bërë. Mos e fillo jetën ushtarake me rrena se, për nur të allahut që është një e dy s'bëhet, e



kur të qaj Lartmadhërinë e Tij, të fus që sot në arrest! Pizeveng!

— Po nuk kam përse të të rrej, bre zotni major, — kishte ngulur këmbë në të tijën Sala, — bile, hasull-hasull, fillova edhe klasën e pestë, por...

— Rrudhe bre gojën, të thonë! Hajvan! Ti ke bërë vetëm një klasë shkollë! — kishte përplasur këmbën përtokë Beshi, shenjë që tregonte se ishte në kulmin e zhvillimit të nervave.

— E ke gabim, zotni komandant. Unë...

Duke hasur në këtë ushtar të trashë e të pa-bindur, majori ishte bërë si i çmendur. Kishte dhënë e kishte marrë me të, por atij meazallah se i ishte mbushur kungulli. Pastaj e kishte shkëputur nga rreshti dhe se ç'i kishte folur, duke tundur kërbacin në dorë. Pastaj i ishte çelur fytyra. E kishte nxjerrë Salën para ushtarëve dhe e kishte pyetur si triumfator:

— Hë, sa klasë shkollë ke ti, qafir? Mendohu mirë kur të përgjigjesh, se për nur të Allahut...

— Unë, zoti komandant, kam një klasë shkollë, — ia kishte kthyer Sala, duke vështruar me bishtin e syrit kërbacin në dorën e majorit.

— Ashtu pra. E dëgjuat ju, qafirë? Ky që deshi të gënjente komandantin e tij më të madh qysh ditën e parë, ka kryer vetëm një klasë shkollë. Kurse unë, që thoni ju, kam kryer dy klasë, domethënë më shumë se çdo njëri prej jush! — u kishte folur i kënaqur Beshi ushtarëve, gjithë kapadaillëk, me gjoksin e nxjerrë përpara...

... Me një fjalë, nuk kishte përse të dyshonte për saktësinë e marrjes së fonogramit nga ana e centralist Salës. I dalldisur pas këtyre mendimeve, përsëri sikur e kishte harruar fonogramin, megjithëse

për të po mendonte. I hodhi sytë mbi atë fletë që i helmoi shpirtin. E vështroi për një çast pa i shkëputur sytë që andej, dhe iu bë se ajo letër e vogël filloi të rritej e të rritej, gjersa zuri gjithë sipërfaqen e tavolinës. Një gjë e tillë i futi lemerinë, prandaj i mbylli sytë menjëherë. Kur i hapi përsëri, iu duk se fonogrami kishte marrë përpjesëtime edhe më të mëdha; ai kishte mbuluar gjithë dyshtemenë dhe muret e zyrës. Mahmut Beshi u shkund një herë fort dhe mjegulla, që i kishte veshur sytë sikur iu davarit. Mbi tavolinë qëndronte fonogrami me atë madhësi që ia kishte sjellë Sala, kurse muret dhe dyshemeja u bënë përsëri ato që ishin. Zgjati dorën të merrte edhe një herë faqoren, por kur u kujtua se ajo prehej e boshatisur diku nga fundi i zyrës, u tërbua edhe më keq. Duke mos patur ku të shfrente inatin, mori kutinë e konservës dhe i nxori fundin sakaq. E përcolli edhe atë pranë faqores së boshatisur dhe duke mos ditur me se të merrej më tutje, zuri receptorin e telefonit.

— Halo! Po, zotni major Beshi, dora vetë, në telefon! — se kujt i foli. — Dëgjo, qafir! Shefi i shtabit, komandanti i kompanisë dhe kapter Kaleshi të paraqiten para meje në mënyrën më urgjente!

Si i dha udhë këtij urdhëri, sytë padashur i vajtën te kalendari. I habitur vuri re se ai shënonte datën katër. I hodhi edhe një sy tjetër fonogramit. Tamam. Atje thuhej «më datën tetë...»

«Si drejtin kështu, — mendoi i lemerisur, — vetëm katër ditë kohë paskemi për t'u përgatitur?»

Kur bëri këtë konstatim, rrëmbeu edhe një herë tjetër receptorin e telefonit dhe thirri me sa i hante zëri:





— More teveqelë, çfarë bëni ju andej, gjumit ia keni këputur? Data tetë nuk don veçse katër ditë që të vijë, kurse ata edepsëzat që kërkova akoma nuk kanë ndërmend të paraqiten!

Matanë telefonit se ç'iu përgjigjën me ca të bëlbëzitura, kur në derë bënë ballë nëntoger Estrefi dhe kapter Kaleshi.

— Zotni major Beshi, — raportoi nëntogeri me qëndrim gatitu, — sipas urdhërit të zotnisë tënde, janë nën këmbët e tua, komandanti i kompanisë, unë nëntoger Estrefi, dhe ky, kapter Kaleshi!

— Ku është ai tjetri, toger Jahja?

— Nuk e dimë me siguri, po besoj se do të jetë atje, zotni major Beshi! — foli këtë herë kapter Kaleshi.

— Hëm! — u kollit Beshi dhe nga inati përplasi këmbën mbi dysheme. — Mirë thua ti, ai qafir do të jetë me siguri andej nga shtëpia e madhe.

Toger Jahja ishte abonuar, si të thuash, në «shtëpinë e madhe», siç e quante ai shtëpinë publike, e cila nuk kishte mbushur muajin që ishte hapur. Sidomos po ia nxirrte lezetin këtë javën e fundit, kohë në të cilën kishin ardhur edhe nja dy italianka, që ia kishin marrë mendjen fare togerit. Megjithëse major Beshi e dinte shumë mirë se një pjesë të mirë të kohës e kalonte atje, nuk ia mbannte t'i fliste qoftë edhe një fjalë të vetme. Nuk mund t'i fliste, jo për gjë tjetër, por sepse toger Jahja ishte bash i nipi i kolonel Dautit, oficer me alamet posti në Ministrinë e Luftës, një fjalë e vetme e të cilit të jepte shkelmin kushedi se ku. Veç kësaj, Beshi nuk ishte aq budalla sa të mos e merrte vesh se, në mos sot, nesër, ky toger kapadai, në sajë të dajos së tij me influencë, do t'i



zinte edhe këtë fije post që i kishte mbetur. Ishte mirë që mos të prishej me togerin, pasi ai do t'i hyn- te në punë në ditë të vështira. Pikërisht për këto arsye Beshi nuk donte ta prishte me të, dhe jo sepse e kishte frikë atë spurdhjak! Por sot, për hir të detyrës, Beshi vendosi të bënte një përjashtim.

— Kalesh! — iu drejtua kapterit majori.

— Urdhëro, zotni major Beshi! — mori qëndrim gatitu.

— Të nisesh në mënyrën sa më urgjente drejt «shtëpisë së madhe». I thuaj toger Jahjes që, për hir të detyrës, të vijë menjëherë në repart!

— Si të urdhërojë zotnia jote, zotni major Beshi! — U përgjegj kapteri, i cili, si nderoi, bëri një prapaktheu dhe u bë gati të fluturonte, kur syri vigjilent i major Beshit vërejti se në xhepin e pasëm të pantallonave të kapterit, kishte nxjerrë kokën paksa një shishe.

— Ndal! Prapaktheu! — e prapësoi urdhërin e parë majori. — Afrou këtu!

Kapteri, që nuk po merrte vesh prapësimin e urdhërit të parë, bëri pak hapa drejt tij.

— Afrou, rrezil!

Kaleshi, duke ndjerë tonin urdhëronjës e të rreptë të komandantit, bëri edhe dy-tri hapa të tjera.

— Akoma, akoma, edepsëz! — e ngriti zërin në kupë të qiellit major Beshi.

Kapter Kaleshi hodhi edhe atë hap të vetëm që e ndante prej tij. Ndjeu se hunda i takoi me atë të Beshit, ndaj u tërhoq pak. Pikërisht në këtë çast e kuptoi manovrën e hollë të major Beshit, prandaj e ndaloi krejtësisht frymëmarrjen dhe qëndroi para tij si ndonjë kufomë.



— Lëshoje firmën, edepsëz, se për nur të allahut që është një e dy s'bëhet... — i hipën xhindet Beshit, dhe kapteri duke parë sytë e tij të zgurdulluar, u çfry si ndonjë komardare e çpuar.

Majorit iu bë sikur i lëshoi dikush ndonjë brroke me raki në fytyrë. Po të kishte qenë vetëm kjo,



gjene mirë; por era e rakisë ishte përzierë me afshin e rëndë të kapterit.

— Përsëri ke pirë, horr? — foli si i çakërdisur Beshi dhe bëri disa hapa mbrapsht. — Sa herë duhet të ta përsëris se për ushtarakun e ushtrisë mbretërore, pijet alkoolike janë të ndaluara?


Kapteri, si njeri që e kuptonte rëndë fajin, qëndronte me kokën varur mbi gjoks, thua se ajo do t'i këputej në çast, si ndonjë mollë e krimbur.

— Me këtë kokë që ke ti, kapter e fillove karrierën, kapter edhe do ta përfundosh, teveqel! Bile ka mundësi që ndonjë ditë të t'i çkul edhe këto grada. Prapaktheu!

Kapter Kaleshi u kthye si të ishte i montuar mbi dy kushineta. I kënaqur sa s'bëhet që kishte shpëtuar vetëm me atë vërejtje, po priste komandën «para», kur ndjeu se një dorë filloi ta trazonte nga xhepi i pasëm. Në fillim ndjeu një gudulisje sa e shkriu fare. Më pastaj një dyndje e vërtetë dhe gjithçka u qetësua. Kapter Kaleshi ndjeu se pantallonat, që deri pak më parë mezi ia mbante rripi, iu lehtësuan e iu bënë pupël. Aksioni personal i major Beshit kishte përfunduar me sukses të plotë.

— Para! — dha komandën majori dhe Kaleshi iu drejtua derës si t'i kishin shkëputur ndonjë copë mish nga trupi.

Si u largua kapteri, Beshi i hodhi një vështrim lakmues profesë. Ishte një alamet shishe e pafilluar, të cilën mezi e kishte nxjerrë nga ai xhepi i ngushtë dhe i thellë si pus. E shtërngoi fort shishen okatë dhe pastaj, në kulmin e gëzimit, e kyçi në kafafortë. Pas gjithë këtij aksioni të suksesshëm, mendja i vajti përsëri te fonogrami. I gjithë gëzimi sikur iu fashit. Ai vetë nuk e kishte provuar ndonjë-





herë në repartin e tij, po kolegët i kishin thënë se pritja e inspektimit ishte e tmerrshme. Mbi të gjitha, në tavolinën e zotërinjve të inspektimit nuk duhej të mungonte asgjë. Dhe, me sa kishte mundur të merrte vesh major Beshi, në magazinë kishite vetëm disa konserva mishi.

«Dreq o punë!» u kujtua. «I harrova fare këto konservat e uruara!» dhe si mbaroi këtë mendim iu drejtua nëntoger Estrefit, që nuk ishte ndjerë fare:

— Shko e më thirrë Salë centralistin dhe paraqitu këtu kur të vinë ata dy të tjerët!

Nëntogeri doli, kurse major Beshi hapi edhe një herë kasafortën, prej ku nxori disa kuti konserva. I numëroi. Ishin nëntë të tilla. Vendosi ta hiqte një mënjanë që të kishte me se të shoqëronte shishen e rakisë që sapo nxori. Në zyrë u fut Salë centralisti.

— Ku e ke atë? — e pyeti Beshi.

Në vend të përgjigjes, Sala nxori nga xhepi një trastë. Ishte trasta, të cilën, sipas urdhërit të major Beshit, e mbante gjithmonë me vete në xhep. E çfarë nuk kishte futur në atë trastë. Çdo gjë që i binte në dorë majorit përfundonte në të, të cilën pastaj Sala e përcillte në drejtim të Lulushe hanëmit.

— Merri këto dhe shpjerja zonjës! — Urdhëroi Beshi duke i treguar konservat.

Brenda pak minutave, Sala mbaroi punë dhe u largua me trastën mbi kurriz.

### KREU III

U desh të kalonte një farë kohe gjersa në zyrë të hynte toger Jahja, nëntoger Estrefi dhe kapter Kalëshi. Fytyra e togerit tregonte qartë pakënaqësinë e atij trazimi.

— Hë, erdhe ti, zoti Jahje? — iu drejtua atij majori me ton dashamirës dhe duke i rrahur shpatullat. — Shumë mirë e bëre, pasi kemi diçka me shumë rëndësi për të komunikuar. — Tha këto fjalë, zuri vend në krye të tavolinës dhe vijoi: — Ju njoftoj, ose, që ta themi më sagllam, fonogrami që sapo mora prej ministrie, njofton se më datën tetë të muajit që jemi brenda, në repartin tonë, për herë të parë, vjen inspektimi!

— Mirë se të na vijë, zotni major Beshi!  
— buçiti si ndonjë altoparlant kapter Kaleshi.

— Ç'mirë se të na urdhërojë, more qafir? Pse, kaq kollaj e quan ti të presësh inspektimin, të cilin ka mundësi ta kryesojë vetë shkëlqesia e tij, gjeneral Aranitasi?

— Ka shumë të ngjarë që ta kryesojë edhe dajua, kolonel Dauti, — sugjeroi toger Jahja.

Ja, kjo gjë nuk i kishte vajtur në mend major



Beshit. Pra, me këtë togerin këto ditë duhej ndënjur edhe më urtë, përndryshe e merrte ferra uratën.

— Po të na vinte zotnia e tij, kolonel Dauti, do të ishte një fitore e madhe për repartin tonë, — foli duke qeshur majori dhe vazhdoi më tej: — Dëgjoni tani. Nuk kemi veçse katër ditë kohë për t'u marrë me përgatitjet. Mendoj të fillojmë nga puna qysh nesër në mëngjes. Puna do të organizohet në këtë mënyrë: Ditën e parë të përgatitjeve, domethënë nesër, do të merremi me qethjet e kokave të ushtarëve, flokët e të cilëve janë rritur (zot m'i fal gjynahet pasi po e bëj për hir të detyrës) edhe më shumë se mjekra e Musli efendisë. Si pasojë, ushtarët e kombit, ushtarët e Lartmadhërisë së Tij, disa rebelë, nuk i quajnë më ushtarë, por morracakë! Në ditën e dytë të përgatitjeve duhet bërë pastrimi i territorit të repartit, i cili kutërbon i tëri. Në të njëjtën ditë duhen mbuluar edhe të gjitha gropat ku janë e ku s'janë nëpër repart, për të evituar ndonjë skandal që mund t'iu ngjasë zotërinjve të inspektimit. Dita e tretë le t'i kushtohet zbulimit të repartit me ca beze të shkruara. Veçse të mos përdoret në asnjë mënyrë bojë e zezë, që mund të na ndjellë ndonjë tersllëk. Gjithashtu të mos përdoret as boja e verdhë. Në ato llafet që do të shkruhen, të thuhet se reparti ynë qëndron si shqipja për mbrojtjen e sundimit të pavdekshëm të mbretit august. Në portën kryesore të repartit, të vendoset një asi beze e shkruar grandioze, si edhe një portret i Lartmadhërisë së Tij (duke dëgjuar këtë emër, të katër u kthyen me fytyrë nga muri ku ishte varur portreti i Ahmet Zogut dhe nderuan). Dhe tani na ka mbetur dita e katërt, dita e fundit e përgatitjeve. Si

thoni ju, me çfarë duhet të merremi ditën e fundit?  
— Me stërvitje! — thirri me sa munda nëntoger Estrefi.

— Mbylle more! — iu kanos major Beshi duke rrudhur turinj të si të kishte ngrënë ndonjë kas-travec të hidhur.

— T'i rreshtojmë ushtarët në të dy anët e rru-gës, për të pritur zotërinjtë inspektorë! — e pasoi kapter Kaleshi.

Major Beshi hapi gojën që t'i vërsulej atij, por në vend të fjalëve i shpërtheu një e teshtitur e fortë. Kapter Kaleshi, duke i ndjerë ato pika të ftohta që i mbuluan fytyrën, filloi t'i fshinte me mëngën e xhaketës.

— Me sa kam dëgjuar nga dajua, kolonel Dauti, — e hapi gojën më në fund edhe toger Jahja, — zotërinjtë inspektora, inspektimin e parë e bëjnë në kuzhinë.

— Aferim të qoftë, bre toger! — i rrahu supet atij Beshi, dhe pastaj duke u kthyer nga dy të tjerët. — Ja se çdo të thotë të jesh njeri me tru, teveqela! Prandaj ngula këmbë unë që të vinte toger Jahja pa derman këtu. Po edhe për kaq gjë nuk jua preu ai kungull që më keni në vend të kokës, bre hajvanë? Po si bre teveqela, shkoni e më harroni kuzhinën! Pa më thuaj ti, — iu drejtua pastaj kapterit, — ç'ushqime kemi në depo?

— Miell, zotni major Beshi.

— Tjetër?

— Asgjë tjetër, zotni major Beshi!


— Si bre asgjë? Po me se ushqehen ushtarët e Lartmadhërisë?

— Me kaçamak, zotni major Beshi!

Gjendja e magazinës së ushqimeve, sikur e



preu edhe më tej major Beshin. Ai e dinte se kap-  
teri i kishte disa konserva të rezervuara si mënja-  
në me urdhër të tij, po prapë, ç'do të bëhej vetëm  
me miell dhe konserva? Pse, i fusnin në gojë kon-  
servat zotërinjtë inspektora? Se mos pak kishin ata  
të tilla nëpër magazinat e ministrisë! Po atëherë me  
se do të shtrohej gostia për nder të tyre? Kjo py-



etje e vështirë e mundoi së tepërmi Beshin e gjorë.

— Dëgjoni, qafirë! — foli pastaj i kënaqur, she-një që tregonte se e kishte gjetur rrugëdaljen. — Qysh nesër të nisen për shtëpi disa ushtarë me leje. Të kihet parasysh që të jenë të gjithë nga fshati dhe në gjendje pak a shumë të mirë. Që të gjithë duhet të kthehen gjallë a vdekur në mëngjezin e datës shtatë. T'i caktohet gjithsecilit prej tyre që, kur të kthehen, të sjellin gjithçka që duhen për gosti-në: pula, gjalpë, raki, vezë... Atij që nuk do të sje-llë, do t'i jepen njëzet e një ditë arrest.

Si dha edhe një seri udhëzimesh të tjera për këtë detyrë, major Beshi urdhëroi ta linin që t'u bënte ballë punëve të mëdha që e prisnin. Kur ata të tre dolën nga zyra, hapi kasafortën, rrxori prej andej shishen e rakisë, të cilën, si e puthi fort, e zbrazti në gurmazin e tharë.



## KREU IV

Gdhiu edhe data katër, dita kur do të fillonte të vihej në jetë plani i punës, i parashtruar me aq zotësi nga major Beshi.

Ushtarët nuk kishin përtypur akoma mirë luginën e fundit të kaçamakut të atij mëngjezi, kur çannga filloi të binte me forcë e pareshtur, thua se plasi lufta. Sapo dëgjuan këtë sinjal, ushtarët u shpërndanë e u zhdukën si t'i kishte përpirë dheu. Komandanti i kompanisë, nëntoger Estrefi, thërriste me sa kishte në kokë. Pas shumë përpjekjesh e kërcënimesh, kompania u grumbullua në një farë rreshti në qendër të repartit.

Toger Jahja, i ngrehosur mbi një grumbull plehrash, në të cilin zhurmonin një trumbë mizash, me paraqitjen e një strategu filloi të fliste:

— Dëgjomëni mua, rebelë! Diçka e madhe po bën vaki në repartin tonë të vogël, kurse ju as që e bëni qejfin qeder, po më futeni vrimave e qosheve! Kini parasysh se Lartmadhëria e Tij e ndritur nuk jua jep kot atë ushqim. . .

— Na ngopi me kaçamak. . . — u dëgjua zëri i mekur i ushtar Dullës që ishte diku nga mesi i rreshtit.

— Pse nuk të pëlqen kaçamaku ty rebel? — ngriti zërin toger Jahja, duke mos ditur kujt t'i drejtohej, pasi s'e dalloj kush i nxori ato fjalë.

— Rroftë e qoftë Lartmadhëria, që na shembi me kaçamak! — thirri me të madhe ushtar Dulla.

— Ashtu pra, rebela! — u kënaq togeri nga një mirënjohje e tillë e ushtarëve për mbretin, dhe pastaj vazhdoi: — Dhe tani dëgjomëni mua: Merrni vesh edhe ju se, pas katër ditësh, në repartin tonë vjen inspektimi nga ministria, i cili, në përfundim të këtij inspektimi do t'i raportojë vetë Lartmadhërisë së Tij, mbretit august!

Në fund të këtyre fjalëve, togeri vetë, nëntoger Estrefi dhe kapter Kaleshi nderuan, kurse nga ana e ushtarëve nuk u ndje as lëvizja më e vogël.

— Nderoni, rebela! — ulëriti me sa kishte në kokë toger Jahja. — Akoma nuk e dini se kur zihet në gojë emri i Lartmadhërisë së Tij (ata të tre nderuan përsëri) vepronet kështu siç vepruan ne?

Pas fjalëve të tij, ushtarët, kush më shpejt e kush më vonë filluan të nderojnë si t'u vinte për mbarë. Një pjesë përplasën duart në gjoks, të tjerë ngritën duart pranë kokës, kurse pjesa më e madhe prej tyre shikonin të çoroditur veprimet e shokëve pranë, duke mos vendosur si të vepronin.

Duke qenë dëshmitar i një rrëmuje të tillë, për togerin u bë gjithçka e qartë: Ata derra ushtarë ende nuk e kishin mësuar nderimin ushtarak të ushtrisë famëmadhe mbretërore. I gjendur përpara këtij fakti të hidhur, togeri vendosi që dy orët e para të asaj dite t'ia kushtonte mësimit të nderimit. Me këtë detyrë ngarkoi komandantin e kompanisë, nëntoger Estrefin.



— Hapni veshët mirë, — e mori fjalën nëntogeri. — Para se të fillojmë nga zbatimi i detyrës për ditën e parë, do të mësoni se si bëhet nderimi në ushtrinë mbretërore. Duhet ta dini se ushtria e Lartmadhërisë së Tij të ndritur ka këtë nderim — dhe, si tha këto fjalë, bashkë me vendosjen gjithë naze e delikatesë të pëllëmbës pranë kokës, përplasi fort edhe thembrat e çizmeve. — Mësoni, gjithashtu, se kur zihet në gojë emri i Lartmadhërisë së Tij, (nderim tjetër nga ana e oficerëve dhe e kapterit) të gjithë ushtarakët, bile edhe civilët, duhet të nderojnë. Ndërsa kur në ndonjë vend ndodhet i varur Lartmadhëria e Tij...

— Rregullo gojën, nëntoger Estrefi! — i tërhoqi vërejtjen toger Jahja. — Lartmadhëria e Tij nuk varet!


— Allabinbelaniversën! — përplasi këmbën për tokë nëntoger Estrefi. — Më ngatërruan këta qafirë! Pra, kur në ndonjë vend hasni në surratin e Lartmadhërisë së Tij, — filloi ai t'u drejtohej përsëri ushtarëve, — atëherë nderimi bëhet me fytyrën e kthyer nga Lartmadhëria. Tani shikoni veprimet e mia. Ju mos bëni asnjë lëvizje.

Nëntogeri u mbush mirë e mirë me frymë, sikur do t'i frynte zjarrit dhe pastaj deklamoi:

— ... do t'i raportoj vetë Lartmadhërisë së Tij, mbretit, hop! dhe dora vihet pranë kaptinës! Hë, e morët vesh? Hajde, provojeni ju tani! Gati?... do t'i raportoj vetë Lartmadhërisë së Tij, mbretit!

— Hop! — buçiti kori i fuqishëm i ushtarëve, të cilët ngritën duart drejt kaptinave.

— Jo, jo hop! Hop nuk ka! Nuk e lejon rregullorja! Hajde, provojeni edhe njëherë... Do t'i raportoj vetë Lartmadhërisë së Tij, mbretit!



Duart e ushtarëve u ngritën përsëri drejt bustinave. Disa ngritën të majtën, të tjerë të djathtën. Një pjesë përplasën thembrat, të tjerë s'lëvizën fare nga vendi.

U desh të kalonte edhe ndonjë orë tjetër mësimi që ushtarët të mësonin pak a shumë nderimin e ushtrisë mbretërore. Meqenëse ishte rasti, nëntoger Estrefi vendosi t'ua bënte të qartë edhe nderimin



në prani të portretit të Lartmadhërisë së Tij. Për këtë qëllim sollën një goxha portret të futur në një kornizë me xham, ku Ahmet Zogu kishte dalë i veshur ushtarak, në këmbë, me tufat e spaletave, që i vareshin, si tufa misri, gjer afër bërrylave.

Megenëse aty afër nuk kishte asnjë vend ku të mund ta vendosnin, se nga gjetën një alamet huri të gjatë. E vendosën portretin majë tij dhe ia dhanë ushtar Dullës që ta mbante lart.

— A e dini se cili është ky, hajvanë? — iu drejtua ushtarëve nëntoger Estrefi, duke u treguar me gisht portretin që nusëronte majë hurit.

Me sa dukej, pyetja qëlloi mjaft e vështirë, pasi asnjë nga ushtarët nuk po përgjigjej. Vetëm pasi kaloi çasti i parë i hutimit, mes ushtarëve u ndje një përshpëritje e lehtë, që sa vinte e rritej. Më në fund njëri nga ushtarët foli me një farë ngurimi:

— Surrati i Ahmet Zogut.

— Çfarë Ahmet Zogu, bre pizeveng i pizenven-gëve! Pse, mos është shoku yt ai, që m'i flet në emër? Zotëria është Lartmadhëria e Tij, Ahme Zogu, mbreti i parë i shqipëtarëve, hajvan! — u çakërdis nëntogeri dhe pastaj filloi të shpjegonte se si bëhej nderimi në prani të surratit të Lartmadhërisë. Ai fliste, ndërsa ushtar Dulla mbante gjithnjë lart hurin. Filluan t'i dridheshin duart, prandaj iu drejtua nëntogërit:

— Zoti nëntoger. A mund ta uli pak se qënka i rëndë, dreqi!

— Rrudh gojën, jezit! — iu hakërrua Estrefi atij dhe pastaj vazhdoi shpjegimin. Demonstroi vetë disa herë radhazi dhe më në fund komandoi:

— Prapa - ktheu!

Duke u rrotulluar kush nga e majta, kush nga

e djathta, të gjithë ushtarët i kthyen prapanicat portretit hijerëndë të Lartmadhërisë.

— Gati? ... do t'i raportojë vetë Lartmadhërisë së Tij, mbretit!

Ushtarët filluan të kthehen me fytyrë nga mbreti. Pikërisht në këtë çast ndodhi diçka e papëlqyer. Dulla, i cili po mbante hurin, majë të cilit rrinte varur mbreti, duke mos dashur të mbetej pas shokëve të tij, i shtyrë nga një qëllim «i lartë dhe fisnik», e hoqi njëren dorë nga huri që kishte shtërnguar. Nga një gjë e tillë ndofta nuk do të ngjiste gjë, por Dulla i rregullt përplasi fort thembrat. Portreti e humbi drejtpeshimin dhe u përplas me tërsëllëmë përtokë. Xhami iu bë copë-copë. Për drej, në atë vend qëlloi një gropë e mbushur me ujë e baltë, kështu që, kur e ngritën prej andej, Lartmadhëria e Tij, jo vetëm që ishte venitur nga ai shkëlqimi i disa sekondave më parë, por as që njihej më.

Duke parë një hata të tillë, nëntoger Estrefi ngriti kamzhikun dhe e fshikulloi me sa fuqi kishte mbi trupin e ushtar Dullës. Vendosi t'i jepte ca ditë të mira arrest, por pastaj ndërroi mendim dhe e dënoi që të sillte gjashtë pula të majme nga shtëpia, simbas urdhërit të dhënë nga major Beshi.

Ky incident i dha fund mësimit të nderimit ushtarak. U vendos të fillohej puna pa humbur kohë për qethjen e kokave të ushtarëve.

—More Estref, po ne nuk e kemi gjetur ende berberin, bre! — u kujtua toger Jahja.

Të gjendur përpara kësaj të papriture, ata të dy dhe kapter Kaleshi u tërhoqën mënjanë, që ta pleqëronin punën.

— Po si drejtin të harrojmë kryesoren e krye-



soreve! — foli i nevrikosur nëntoger Estrefi. — Me se do t'i qethim ushtarët tani?

— Të marrim ca gërshërë dhe le ta qethin vetë njëri-tjetrin, zoti toger Jahja, — propozoi kapter Kaleshi. — Atje në fshatin tim, të gjithë kështu qethen.

— Pusho more ti! — i çfryu toger Jahja. — E ku ka bërë vaki që ushtarët e mbretit të qethen me gërshërë e t'u bëhen kaptinat shkallë-shkallë?

Menduan sa menduan për këtë problem kaq të koklavitur dhe më në fund nga kjo situatë e vështirë i nxori vetë togeri, i cili u lëshua në pikë të vrapit drejt berberhanes së usta Tafës.

## KREU V

Berberhana e usta Tafës ishte e vetmja që kish-te nënprefektura e Zerenit. Duke qënë një tek, toger Jahja nuk u habit aspak kur pa gjithë ata njerëz që prisnin radhën në këmbë. Veç kësaj, të nesërmen gdhihej dita e parë e bajramit të madh dhe njerëzit, me këtë rast, po qetheshin e rruheshin si asnjë ditë tjetër. Toger i çau me bërryla turmën e njerëzve që sa s'po shtypnin njëri-tjetrin në atë dyqan të ngushtë ku të merrej fryma dhe si iu afrua usta Tafës, i tha të merrete çirakun, të mbyllte menjëherë dyqanin dhe ta ndiqte pas.

— Çfarë po më thua, brë zoti toger! — shqeu sytë usta Tafa. — Po zotnia jote a nuk e shikon se i gjithë ky millet pret briskun dhe gërshërët e mia?

— Leri llafet, usta! Mbreti të kërkon në krye të detyrës!

— Pash rabilaleminin më lerë të punoj pak, zotni toger, — filloi t'i përgjërohej usta Tafa. — Zotrote e di se bajrami vjen një herë në vit, dhe ne berberët mezi e presim këtë ditë.

— Dëgjo, rebel! Do të vish me të mirë ti, apo t'iu bëj zë xhandarëve të vijnë e të të heqin zvarrë deri në repart? — u nxi në fytyrë toger Jahja.

Usta Tafa, pa ç'pa, filloi të hiqte bluzën, e cila nuk dallohej më se ç'ngjyrë kishte patur kur ishte qepur.



— Tafë, po mua kështu do të më lesh? — u ankua klienti që kishte në dorë, me fytyrën tërë shkumë.



— Mbylle gojën ti! — iu vërsul atij toger Jahja. — U bë edhe mjekra jote të dalë përpara urdhërave të Lartmadhërisë së Tij! Hajde, hidhi nja dy grushta ujë atij surratit tënd, dhe zhduku!

— Na falni kusuret, burra! — iu drejtua usta Tafa klientëve që po ndiqnin gjithë interesim bisedën e tyre. — Mbreti na kërkon për të mbrojtur kombin me brisk e gërshërë, prandaj dukuni më vonë.

Klientët filluan të delnin një nga një duke mërmeritur diçka të pakuptueshme nëpër dhëmbë. Usta Tafa dhe çiraku i tij, mbylën dyqanin dhe ndoqën nga pas toger Jahjen.

## KREU VI

Ndërkohë që toger Jahja po jepte dhe po merrte me usta Tafën, nëntoger Estrefi dhe kapter Kaleshi ishin mbyllur në magazinën ushqimore të repartit për të provuar disa konserva mishi të ndarra mënjanë. Të dyve as që u bënte ndonjë përshtypje kushedi çfarë ardhja e inspektimit nga ministria. Që të dy kishin arsye të forta për këtë. Nëntoger Estrefi po bënte dhjetë vjet që mbante në trup uniformën e oficerit të ushtrisë mbretërore dhe gjatë kësaj periudhe kishte arritur vetëm gradën e nëntogerit, nga aspirant që e kishte filluar karrierën. I pakënaqur nga një gjë e tillë, ia kishte varur krejt detyrës. Veçanërisht i vinte plasje kur shikonte se ai buzëqumështi, toger Jahja, sillej sikur të ishte vetë komandant, dhe s'pyeste jo për thinjat e tij, por as për vetë major Beshin.

Puna e kapter Kaleshit ndrronte kryekëput nga ajo e nëntogerit. Ky ishte ana e kundërt e tij. Ngaqë ishte shumë i kënaqur me atë detyrë, e kishte humbur fare nga kënaqësia. Ai kishte rënë, si të thuash, si pula në grurë. Sidomos e kishte vënë kapelen mbi sy kur i kishin dhënë detyrën e magazinierit të



ushqimeve. Sa të kishte atë magazinë, kapteri nuk pyeste për kërkënd. Ishte në gjendje ta rregullonte punën jo me major Beshin, por, po të ishte nevoja, edhe me gjeneral Aranitasin. Garanci e plotë për këtë ishin trastat që delnin herë pas here nga magazina, të cilat merrnin udhë me drejtime nga më të ndryshmet.

Ndërsa nëntogeri dhe kapteri ia kishin shtruar për shtatë palë qejfe në magazinë, ushtarët ishin shpërndarë sa andej këtej nëpër qoshet dhe skutat e repartit. Dikush ia kishte këputur gjumit, të tjerët ishin rreshtuar pas murit të fjetores për të thithur ato pak rreze të atij dielli pranveror. Disa prej tyre kontrollonin flokët e njëri-tjetrit, pasi kohët e fundit, kokat kishin filluar t'iu hanin tmerrësisht dhe kap-ter Kaleshi kishte tre muaj pa ua dhënë atë cefël sapun që ua kishte caktuar Lartmadhëria.

Në rrugë u duk toger Jahja, i ndjekur nga usta Tafa dhe çiraku i tij. Një ushtar, sapo i pa, thirri me të madhe, thua se po jepte sihariqin e lirit nga ushtria:

— Erdhën, erdhën berberët!

Si dëgjuan këtë zë, nga magazina dolën nëntogeri dhe kapteri me buzët gjithë lyrë. Toger Jahja u ndal pranë tyre.

— I solla, — tha duke dihatur. — Filloni menjëherë!

— Pirolla<sup>1)</sup> të qoftë bre zotni toger Jahja! — i shtërngoi dorën fort kapteri, dhe, duke u kthyer nga usta Tafa, shtoi: — Fillojmë, usta?

---

1) Pirolla — të lumtë.

Mirëpo usta Tafa, kur mësoi se e kishin marrë për të qethur një kompani të tërë me ushtarë, me flokët gjer te veshët, bëri be e rrufe se nuk e bënte një punë të tillë, punë e cila do t'i hante një pjesë të mirë të asaj dite, në të cilën shpresonte të nxirrte të ardhura të mira në dyqan. Ata të tre, kur panë se kishte rrezik që usta Tafa të ikte me gjithë mend, vunë në përdorim gjithë autoritetin e tyre ushtarak që ta trembnin, po do ti, ky usta Tafa paskej patur një kokë që aman o zot! Kur panë se kërcënimet nuk i bënë asnjë përshtypje, ia filluan nga të luturat. U lëshuan një lumë i tërë fjalësh le-dhatuese, po usta Tafa në të tijën se në të tijën. I thanë se nderi dhe lavdia e repartit të tyre qëndronte në maqinën e tij të qethjes, hiç! I thanë se Lartmadhëria e Tij patjetër do të vihej në dijeni për aktin patriotik të usta Tafës, i cili kishte mbyllur berberhanen një ditë para bajramit që t'i shërbente ushtrisë mbretërore, meazallah! Atëherë situatën e mori në dorë kapter Kaleshi. I futi krahun gjithë dashamirësi usta Tafës dhe e hoqi mënjanë. Kishte vendosur të shkruhe fishekun e fundit, atë fishek që e kishte nxjerrë gjithmonë faqebardhë.

— Dëgjo, usta, — filloi t'i fliste si u larguan pak. — Me sa di unë, në qytet e kudo është krizë mielli.

— Krizë është, — aprovoi ustai që nuk po i binte në të kurrsesi se ku donte të delte tjetri.

— Kurse unë kam dëngje të tëra, — vazhdoi kapteri, duke i shkelur syrin në mënyrë kuptim-plote.

Usta Tafa e kuptoi se ku rrihte çekani. Megjithëse i erdhi mirë nga një propozim i tillë, përsëri tundi kokën në shenjë mohimi.



— Dëgjo, kam edhe disa konserva mishi, jo mish derri (pthu!), po lopë safi që t'i lëpish gish-trinjtë nga lezeti, merr vesh ti? — e zgjidhi gjuhën edhe më tej Kaleshi. — Merr një dëng miell dhe nja dhjetë konserva të tilla dhe fillo nga puna, hajt!

— E di si është puna, zotni kapter, — ia ktheu ustai, — edhe Bakiu, ai oficeri që u transferua, kësh-tu si zotrote më tha njëherë, mirëpo, si e hodhi lumin, më tha, me nder zotnisë tënde, të pj . . . . . kalin!

— Dëgjo usta, — u prek në sedër kapteri, — unë nuk jam Bakiu, po kapter Kaleshi me një barrë mustaqe, more vesh? Veç kësaj, unë nuk jam si ai Bakiu yt që gjithë ditën tundte në dorë çelësat e zy-rës ku thyenin kokën minjtë. Që ta marrësh vesh edhe ti se me mua nuk bëhet shaka, unë jam ma-gazinieri i ushqimeve të repartit! Dhe kur them unë kështu, kështu do të bëhet. Këtë e kanë pro-vuar burra edhe më të mirë se ti, merr vesh?

— Ashtu është, si thua zotrote, unë as që dy-shoj në ndershmërinë e zotrisë tënde, por, meqë-nëse u dogja njëherë nga qulli, e kam vendosur që t'i fryj vazhdimisht edhe kosit.

— Medemek, nuk ke besim në burrërinë time, ë? — foli kapteri me nervozizëm.

— Nuk është punë besimi, po . . .

I nevrikosur nga fjalët e usta Tafës, kapter Kaleshi i bëri zë njërit prej ushtarëve dhe bashkë me të u turr drejt magazinës. Nuk shkoi shumë dhe u kthyen përsëri. Mbi kurrizin e ushtarit rëndonte një alamet thesi, pesha e të cilit e kishte palosur më dysh ushtarin e gjorë.

— E more vesh apo jo! — i foli Kaleshi gjithë kapadaillëk usta Tafës. — Mua më thonë kapter



Kaleshi dhe jo Baki! — Dhe si tha këto fjalë, e urdhëroi ushtarin ta lëshonte thesin pranë këmbëve të ustait.

— Po ato? .. — pyeti ustai.

— Ky është kapari, — i tregoi thesin kapteri, — tepricën do ta marrësh kur të mbarosh punën.

Deshi, s'deshi, usta Tafa u detyrua t'i bënte zë çirakut dhe sakaq të dy filluan nga puna.

Nga dreka usta Tafa dhe çiraku i tij morën fry-



më lirisht. Kompania e ushtarëve ishte qethur, gjë që, përveç kokave të ushtarëve që shndrisnin, e provonte më së miri edhe një grumbull flokësh që ishte në qëndër të repartit.

Ustai i vuri thesin e miellit mbi kurriz girakut, mori edhe konservat nga kapteri dhe u nis të hapte berberhanen, ku, me siguri ishte në pritje një mi-let i madh në pragun e atij bajrami.

## KREU VII

Të nesërmen në mëngjez, para se të fillonte detyra e re sipas planit, major Beshi mori në inspektim kompaninë, për të verifikuar nëse kishte përfunduar vërtetë më së miri dita e parë e përgatitjeve, ashtu si i kishin raportuar, apo jo. Nëntoger Estrefi i paraqiti forcën dhe, kur mësoi nga majori qëllimin e vizitës së tij, komandoi kompaninë:

— Kësula, hiq!

Duke parë kokat, që i zbardhëlljen para syve, major Beshi iu duk se ndodhej para ndonjë parcele të mbjellë me lakra armeje.

— Dëgjoni këtu, qafirë! — iu drejtua ushtarëve i kënaqur nga një punë e tillë e paqme, — dita e parë e përgatitjeve paska kaluar për birinxhi, gjë që e vërtetojnë kokat tuaja. Kjo tregon edhe një herë kujdesin e madh të Lartmadhërisë së Tij, i cili harxhon gjithë ato fonde e napolona për qethjet e kokave! Me allahun përpara, dhe me Lartmadhërinë e Tij të ndritur nga pas, përpara, qafirë e filloni nga puna për zbatimin e planit të ditës së dytë, simbas planifikimit të komandës!

Pas kësaj ceremonie të shkurtër, por të domos-



doshme, nëntoger Estrefi filloi t'u ndante detyrat togave. Një luftë e ashpër u zhvillua ndërmjet tri togave, kur erdhi puna se cila prej tyre do të merrej me pastrimin e territorit pas fjetoreve, detyrë e cila, si më delikate dhe me më përgjegjësi, iu ngarkua togës së tretë, me përgjegjës direkt kapter Kaleshin. Përfundimisht detyrat u ndanë në këtë mënyrë: toga e tretë do të pastronte territorin pas fjetoreve, e para do të pastronte territorin e repartit nga çdo mbeturinë (dhe me të tilla ishte plot e përplot repartit); kurse e dyta do të merrej me transportimin e grumbullit të flokëve që ishte krijuar në mes të repartit dhe me mbulimin e gropave që haseshin kudo nëpër repart. Si u ndanë detyrat, major Beshi u largua, kurse togat u drejtuan për në vendet e tyre të punës. Ndërsa togat e tjera u nisën me këngën e Lartmadhërisë në gojë, e treta u nis e heshtur drejt territorit pas fjetores, nga ku vinte një erë e qelbur që kutërbonte në tërë repartin.

— Këndoni, derra, këndon! — çirrej me sa kishte në kokë kapter Kaleshi, duke parë se asnjëri prej ushtarëve nuk po e hapte gojën. — Këndoni se nuk po ju çojmë në varr! Vetë e keni fajin që hani gjithë atë kaçamak tri herë në ditë!

Nën kërcënimin e të sharave dhe të thirrurave të tij, në fillim vetëm një zë i çjerrë e pastaj e gjithë toga, ia mori këngës zvarr-zvarr, sikur po përcillnin ndonjë kufomë:

*Rroftë, Zogu i Parë, rroftë,  
shpëtimtari i mëmëdheut,  
brez pas brezi mbretëroftë  
nëp stërnip i Skënderbeut...*



Pastaj, po me këngë në gojë, përveshën llërët dhe ia filluan asaj detyre sa të rëndë aq edhe delikate.

Duke mos i rezistuar dot deri në fund asaj ere, që nga trazimet mori përpjestime edhe më të gjera, kapter Kaleshi vajti e u mbyll në magazinën pranë. Ushtar Dulla, Vata dhe nja dy a tre të tjerë, që po punonin pranë njëri-tjetrit, si panë se kapteri u largua, kush me të mërmëritur e kush me zërin të



ngritur në kupë të qiellit, filluan të këndojnë tërë pasion:

*Shkoftë, Zogu i Parë, shkoftë,  
shkatërrimtari i atdheut,  
brez pas brezi u mbuloftë  
gjer në fund, në fund të dheut...*

Puna dhe kënga zienin në repart. Melodia e këngës së Lartmadhërisë shkoi e u fut gjer në magazinën ku ishte mbyllur kapter Kaleshi. I kënaqur sa s'bëhet nga «patriotizmi» i ushtarëve që po ngjirreshin me këngën e Lartmadhërisë, nxori kokën dhe u foli:

— Kështu, derra, kështu ju do Lartmadhëria e Tij! Punoni dhe këndon! Dhe tash e tutje mos hani shumë kaçamak se përsëri kjo punë ju pret!

Ai u fut përsëri në magazinë, ndërsa ushtarët, duke i shkelur syrin njëri-tjetrit, i ngritën edhe më zërat:

*Shkoftë, Zogu i Parë, shkoftë,  
shkatërrimtari i mëmëdheut...*

oo 0 oo

Pas një pune të tillë, ushtarët e panë më se të nevojshme të laheshin.

— Sikur t'i merrnim lejë kapterit e të shkonim të laheshim në lumë? — tha ushtar Vata.

— Shkojmë me tonën, se sa për Kaleshin, ai nuk na jep lejë kurrë! — ia ktheu Dulla.

U nisën të gjithë së bashku drejt lumit që s'ish-te veçse pak minuta larg.

— Sa muaj i bëmë? — pyeti njëri nga ushtarët. Dulla, që ecte përkrah tij, nuk iu përgjegj me-

njëherë. Kapi fundin e rripit dhe filloi të numëronte disa shkallëzime të prera me brisk në të.

— Nëntë muaj thotë rripi, — ia ktheu si i numëroi ato.

— Nëntë? — u habit tjetri. — Kurse mua më duket sikur kemi vite të tëra këtu.

— Eh, sikur të kishim fatin e atyre ushtarëve që bënë vetëm nga gjashtë muaj ushri! — tha mendueshëm Dulla.

Shokët e tij e vështruan të habitur, duke kuptuar se për cilët ushtarë bënte fjalë ai. Duke parë habinë e tyre, Dulla filloi t'u tregonte:

— Kur i bënë atentat Ahmet Zogut, një pjesë e ushtarëve nuk kishte veçse gjashtë muaj që ishin mobilizuar. Gjer në atë kohë, ky kapter Kaleshi, që kemi ne sot, ishte pastrues i zyrave të komandës. Zagarët e Zogut ishin në merak nga ai atentat i rrezikshëm, ku Zogolli kishte marrë një plagë bajagi të rëndë. Megjithëse kishin kaluar tri ditë nga plagosja, doktorët ende s'ishin të sigurtë për shpëtimin e tij.

Në ditën e katërt pas plagosjes, Kaleshi, që shkoi andej nga nënprefektura, kishte dëgjuar nënprefektin, që ishte duke folur në telefon me Tiranën, se Ahmet Zogu, ishte jashtë çdo rreziku. Kaleshi harroi fare se për ç'punë kishte vajtur në pazar, dhe ishte kthyer në repart duke vrapuar e duke bërëtitur, dhe pasi kishte hapur derën si i çakërdisur, i kishte dhënë Beshit këtë lajm. Beshi, i kënaqur sa s'bëhet nga një sihariq i tillë, kishte dalë në dritare dhe i kishte bërë firar ata pak fishekë që i kishin ndodhur në patllake. Duke dëgjuar ato krisma, ushtari që ishte roje tek porta e komandës, duke menduar se do të ishte sulmuar komandanti tek punonte në



zyrën e tij, kishte shprazur pushkën drejt dritares. Njëri nga plumbat e kap paksa në shpatull Beshin. Në repart menjëherë ishte dhënë alarmi. Pushkë të tëra u shkrehën në erë, thua se plasi lufta. Kur më në fund ishte sqaruar gjithçka dhe krismat kishin pushuar, Beshi, si shpërblim për lajmin gazmor dhe për gjakun e derdhur me rastin e shpëtimit të Lartmadhërisë, i kishte vënë Kaleshit menjëherë spale-tat e kapterit të ushtrisë mbretërore. Kështu, falë atij plumbi që goditi Ahmet Zogun, Kalesshi fitoi gradën e kapterit, përndryshe edhe sot e kësaj dite do të ishte pastrues i zyrave të komandës. Të nesërmen e kësaj ngjarjeje, nëpër të gjithë repartet ushtarake u shpërnda një qarkore, me anën e së cilës njoftohej se me rastin e shpëtimit të Ahmet Zogut, ushtarët e mobilizuar para gjashtë muajsh liroheshin nga ushtria. Ushtarët, të gëzuar sa s'thuhet nga ky lajm, aty për aty kishin sajuar këto vargje:

*Le ta dijë bota mbarë,  
se mbreti ynë shqiptar,  
nuk është magjar  
dhe as tamahqar,  
po mban veç gjashtë muaj ushtar  
e kursen drithin në hambar...*

Dulla e mbaroi tregimin e tij dhe të tjerët ia dhanë gazit me të madhe, sidomos nga vargjet e këngës.

Duke biseduar gjithnjë për historinë e treguar nga Dulla, arritën në breg të lumit. Megjithëse në të hyrë të pranverës, u zhveshën komplet dhe u futën në ujin e ftohtë. U lanë mirë e mirë, u veshën dhe pastaj u drejtuan për në repart.

## KREU VIII

Ndërsa në repart po bëheshin përgatitje të ethëshme për ta pritur në mënyrë sa më të shkëlqyer inspektimin, major Beshi ishte mbyllur me rrethkomandantin e xhandarmërisë në zyrën e këtij të fundit, për të bërë një dorë tavëll. Majorit, për çudi, atë ditë nuk po i ecte zari, megjithëse e mbante veten si mjeshtër të rrallë të kësaj loje. Kishin zhvilluar gjashtë lojë dhe të gjashta i kishte humbur. Dhe bashkë me lojat kishte humbur edhe gjashtë napolona. Domethënë nga një për çdo lojë. Si përfundim, xhepat e komandantit të repartit ishin boshatisur krejtësisht. I tërbuar nga një shans i tillë i keq, Beshi vendosi të provonte edhe lojën e shtatë, prej ku, siç u shpreh vetë, të delte «ose fllanxë ose topanxhë»! Domethënë, ose t'i rifitonte ato gjashtë napolona, ose të linte edhe aq akoma. Mirëpo rrethkomandanti vërtet ishte xhuxhmaxhuxh nga trupi, por kokën e kishte plot ama. Ai e pikasi menjëherë se Beshi do të ishte bërë teneqe nga xhepat, prandaj propozoi që napolonat e reja të viheshin mbi tavolinë. I zënë ngushtë, major Beshi filloi të kruante ata xhepa të thellë, nga fundi i të cilëve mundi



të nxirrte vetëm një tufë me çelësa. U mundua t'i mbushte mendjen se po qe se do të humbiste do t'ia dërgonte napolonat sa të vente në shtëpi, po rrethkomandanti nuk e pranoi një konditë të tillë. I nevrikosur sa s'bëhet, major Beshi u ngrit nga karrikja që të largohej, kur ndjeu peshën e patllakes që i varej në brez. Një gjë e tillë e bëri të ulej në vend përsëri. Gjithë kapadaillëk, e nxori atë nga këllëfi, e përplasi mbi tavolinë dhe kapi zaret për të filluar lojën. Rrethkomandanti i xhandarmërisë e mori patllaken në duar dhe e vështroi mirë e mirë **nga të gjitha anët. Jo për gjë tjetër, po** vetëm e vetëm sepse atij para ca ditësh i kishe humbur patllakja e tij në mënyrë misterioze, ndërsa po pinte te kafja e Nuzit. Ajo e Beshit nuk ishte e vetja, por sidoqoftë iu paraqit rasti të zëvendësonte patllaken e humbur. Kapi zaret edhe ai. Që të dy ishin të vendosur për fitore. Beshi përpiqej të fuste edhe një herë në xhep napolonat e humbur, kurse rrethkomandanti të fuste patllaken në këllëfin që prej ditësh i varej bosh për brezi. Major Beshi bëri shesh-beshin e parë, kur tringëlliu zilja e telefonit. Në fillim asnjëri nuk ia vari, po kur panë se ajo nuk ishte punë që pushonte, rrethkomandanti, duke mos i shkëputur sytë nga tavolina ku po zhvillohej loja, u ngrit të merrte vesh përse po e shqetësonin.


— Po, në telefon dora vetë. Si? Ka rënë zjarr në repartin ushtarak? Mirë, mirë, ja po nis menjëherë zjarrfikësen dhe komandantin e repartit, major Beshin!

Duke dëgjuar këto fjalë, në fillim, major Beshi ngriu i tëri, por pastaj vuri buzën në gaz gjithë shejtanllëk.

— Ka rënë zjarri në repart, — tha komandanti

i xhandarmërisë. — Duhet të nisesh menjëherë!

— Pa mbaruar loja e shtatë, jo zjarr, po sikur edhe vullkan të ketë shpërthyer, ne të dy nuk do të lëvizim prej këtej! — ia ktheu i vendosur major Beshi.



Duke hasur në vendosmërinë e tij, rrethkoman-  
danti doli në dritare dhe i foli dikujt:

— Karroca zjarrfikëse të niset menjëherë në  
drejtim të repartit ushtarak!

Fill pas këtij urdhëri, loja e shtatë e tavllës



rifilloi edhe më me zjarr e inat. Major Beshi po i shkrinte njohuritë e tij për të futur në xhep napolonat e humbur, kurse rrethkomandanti luste zolin që ta fitonte edhe atë lojë, e cila do t'i zëvendësonte patllaken e humbur në mënyrë misterioze te kafja e Nuzit. Loja ishte në kulmin e zhvillimit të saj.

\* \* \*

Në repart, puna për pastrimin e territorit kishte mbaruar për bukuri. Të gjitha mbeturinat e mbledhura nëpër repart: letra, grumbulli i flokëve, rreçka e ku di unë çfarë, formuan një kodër mu pas fjetoreve të ushtarëve. Për të mos humbur kohë me transportimin e tyre jashtë repartit, toger Jahja urdhëroi që grumbullit të plehrave t'u vihej flaka menjëherë. Urdhëri i tij u zbatua. Sakaqgjuhët e flakëve u ngritën lart, gjer në çatinë e fjetores më të afërt të ushtarëve, e cila, për maskim, para dy vjetësh kishte qënë mbuluar me degë dushku. Një gjuhë flake se si preku dushkun e tharë mbi çatinë e fjetores dhe sa të hapësh e të mbyllësh sytë, flaka u përhap në gjithë çatinë e saj, si të ishte lëshuar mbi të ndonjë kovë me lëndë djegëse. Toger Jahja, kur pa këtë hata, filloi të çirrej e të bërtiste me të madhe, ndërsa ushtarët vraponin si të trullosur andej këtej, duke mos ditur si të vepronin. Për fat të keq reparti i tyre nuk kishte ujë. Ndërkohë flaka merrte përpjestime gjithnjë e më të gjera. Toger Jahja, si ndonjë hero, u sul të hapte derën e fjetores që të shikonte nëse flaka kishte shpërthyer edhe brenda, kur një gjuhë flake iu përplas në fytyrë. Duke lëshuar një britmë të tmerrshme, mbuloi fytyrën me dy duart dhe ia dha vrapit tutje, larg flakës. Ai po

vraponte i tmerruar, me fytyrën e përzhitur, kur sa nuk u përplas pas një karroce që po ecte si e çmendur. Ishte karroca zjarrfikëse e xhandarmërisë që po vinte trokthi. Mbi të ishte vendosur një goxha fuçi, në rubinetin e së cilës ishte montuar një alamet zorre e gjatë. Sakaq karroca zjarrfikëse filloi nga puna për shuarjen e zjarrit. Zorra villte ujë parreshtur. Po për çudi, flaka, në vend që të ulej, merrte përpjestime gjithnjë e më të mëdha. Papritur, flaka si një përbindësh, përshkoi si shirit i zjarrtë zorrën e llastikut dhe vajti e u mbërthye mbi karrocën zjarrfikëse. Kali filloi të hingëllinte vajtueshëm. Si pa se po e përpinin flakët, kali i zgjuar, e braktisi frontin e tij të luftimit dhe ia dha vrapit tutje si i çakërdisur. Nuk kishte bërë veçse pak metra udhë, kur u dëgjua një plasje e fortë që tronditi nga themelet jo vetëm repartin ushtarak, por tërë qytetin. Kali, bashkë me karrocën zjarrfikëse, u mbuluan nga flakët që sikur dolën nga toka.

\* \* \*

Çfarë kishte ngjarë në repartin ushtarak vallë? Duke parë atë flakë që kishte shpërthyer në çatinë e fjetores, xhandari i shërbimit të Zerenit kishte njoftuar menjëherë rrethkomandantin e xhandarmërisë se në repartin ushtarak kishte rënë zjarr. Simbas urdhërit të marë nga rrethkomandanti, përgjegjësi i karrocës zjarrfikëse, xhandar Xhabiri, ishte sulur si shigjetë drejt stallës dhe kishte mbrehur kalin. Si kishte mbaruar këtë punë kishte vrapuar drejt fuçisë së madhe të ujit, dhe, me ndihmën e disa xhandarëve të tjerë, e kishte vënë atë mbi karrocë. Shpejtësia e xhandar Xhabirit kishte arritur kulmin e përsosmërisë. Mirëpo, në nxitim e sipër në vend



që të vinte mbi karrocë fuçinë e ujit dhe pompën, kishte vënë atë të benzinës që ishte ngjitur me të. Me fuçinë e benzinës mbi karrocën zjarrfikëse me pompën dhe me bilbilin në gojë, që i vërshëllente parrështur me faqet e fryra në vend të sirenës, mori udhë me të katra drejt repartit ushtarak. Kur kishite filluar punën për shuarjen e zjarrit, benzina, e rënë në kontakt me zjarrin, shkaktoi një flakë që mori qiellin. Kjo flakë përpiu jo vetëm fjetoren e ushtarëve, por edhe karrocën zjarrfikëse bashkë me kalin. Si finale e kësaj ngjarjeje, fuçia e «ujit» u hodh në erë.

Në zyrën e rrethkomandantit të xhandarmërisë, loja e shtatë e tavlës kishte përfunduar me sukses të plotë për major Beshin. Bashkë me patllaken që e kishte futur përsëri në këllëfin e tij, kishte rrasur në xhep edhe të gjashtë napolonat e humbur më parë. I gëzuar në kulm nga kjo fitore, ishte sulur drejt repartit që të verifikonte atë «zjarr» të sajuar gjithë shejtanllëk nga rrethkomandanti. Qerrat! Për ta detyruar Beshin që të ngrihej nga loja, kishte sajuar atë lojën e zjarrit. Rrethkomandanti ishte mjaft i zgjuar, por ama edhe major Beshit nuk ia hante qeni shkopin. Pse, e hante alamet majori një tek të tillë?

Kur sosi në repart dhe pa fjetoren të bërë shkrumb e hi, u tmerrua. Pak më tej, me patkonjtë drejt qiellit, ishte skeleti i djegur i kalit. Mbi të vajtonte akoma xhandar Xhabiri, i cili kishte shpëtuar si me magji. Por të gjitha këto humbje materiale e humbën efektin e tyre kur pa fytyrën e djegur e të përcëlluar të toger Jahjes. Toger i gjorë ishte shëmtuar sa s'njihej. Vetullat, qerpikët dhe mustaqet e tij të holla, kishin humbur pa nam e pa ni-

shan. Një mizori e tillë e revoltoi së tepërmi Beshin. Nga raporti që i dha vetë togeri, majori arriti në përfundimin se në këtë sabotim të paparë e të padëgjuar ndjehej dora e rrafinuar e rebelëve sabotatorë, të cilët, kohët e fundit kishin filluar të vepronin edhe në qytetin e tyre të vogël e të qetë. Nuk kishte nevojë për asnjë koment të mëtejshëm. Sabotimi ishte kryer nga rebelët, dhe nuk ishte çudi që ata mund të ndodheshin edhe në mes të ushtarëve.

Duke nxjerrë këtë përfundim, majori u sul drejt zyrës së tij dhe filloi nga përpilimi i një shkrese urgjente. Me anë të kësaj shkrese njoftonte Ministrinë e Luftës mbi këtë «akt terrorist» të paparë, i cili bëhej me qëllime të paramendura për të diskredituar ushtrinë mbretërore në prag të inspektimit, mbi përpjekjet heroike të toger Jahjes, nipit të zotit kolonel Dauti, i cili ishte përleshur fytafyt me flakët. Njoftonte gjithashtu për djegien e fjetores së ushtarëve me gjithë çfarë kishte brenda, gjë e cila tregonte se rebelët nuk e shikonin me sy të mirë rehatinë dhe komoditetin e ushtrisë mbretërore, si edhe për ngordhjen e kalit, i cili, edhe ky, kishte dhënë jetën në mes flakëve për të shpëtuar pasurinë e ushtrisë famëmadhe mbretërore. Në fund shtoi se si komandant i këtij reparti heroik dhe si dëshmitar i asaj ngjarjeje tronditëse, propozonte që si shpërblim të heroizmave të tij të pashoqe, toger Jahjes t'i jepej menjëherë grada e kapitenit si dhe një shpërblim i majmë.



## KREU IX

Në agimin e ditës pasardhëse, reparti ushtarak i Zerenit i ngjiste një fushe ku pak kohë më parë do të ishte zhvilluar një betejë e ashpër. Shtabi i repartit, me major Beshin në krye, kishte rënë në hall të madh nga gjendja e krijuar. Nuk dinin se ku t'i përqëndronin forcat më parë. Të merreshin me hetimet e atij sabotimi të bërë në prag të inspektimit, të pastronin rrangullat e mbetura nga djegia e fjetores, apo të vazhdonin punën sipas planifikimit të ditës së parë. Gjithësecila prej këtyre punëve kishte rëndësinë e saj të madhe, dhe shtabi i mbledhur për këtë qëllim, nuk po i jepte dum. Në mes tyre nuk mungonte as toger Jahja, i cili, megjithëse me vetulla, qerpikë dhe mustaqe të djegura, ishte paraqitur në krye të detyrës. Pas shumë debatesh arritën në përfundimin që puna të vazhdohej simbas planifikimit të bërë nga major Beshi. Hetimi në lidhje me sabotimin e kryer, priste deri sa të largohej inspektimi. Në të njëjtën kohë, toger Jahja, edhe pse i plagosur, nuk mënoi të propozonte që mbeturinat e fjetores së djegur të mos lëvizeshin fare nga vendi, dëshmi e gjallë për zotërinjtë e in-

spektimit për sabotimin kriminal. Pra, nuk mbetej gjë tjetër veçse të filllohej menjëherë nga zbukuri-mi i repartit. Mirëpo edhe për këtë punë dolën një seri pengesash serioze. Më kryesorja prej tyre ishte mungesa e bezeve të shkruara, dhe veçanërisht mungesa e surratit të Lartmadhërisë së Tij. Edhe këtë punë, ashtu si me usta Tafën, e zgjidhi më së miri kapter Kaleshi, i cili mori kontakt menjëherë me një «pikturist» që pranonte të shpërblehej për mundin e tij me sende në natyrë. Nga ana tjetër, zotnia e tij, nënprefekti, pranoi t'i u jepte hua për pak ditë surratin e Lartmadhërisë që kishte në zyrë.

Pak orë pas këtyre rropatjeve e përpjekjeve, nga dora e pikturistit doli parrulla e parë, në sfondin e zi të së cilës, me shkronja të bardha ishte shkruar:

«MIRË SE VINI, ZOTËRINJ INSPEKTORA!»

Kjo ishte parrulla kryesore. Do të vendosej mbi portën e madhe metalike të hyrjes, nën portretin madhështor të Lartmadhërisë. Kjo punë e vështirë dhe me rëndësi të jashtëzakonshme iu ngarkua ushtar Dullës dhe ushtar Vatës. Dy ushtarët, me parrullën në duar, kishin kohë që po haheshin me njëri-tjetrin. Njëri thoshte se parrulla ishte shumë e gjatë dhe se për këtë duheshin zhvendosur dy shtyllat metalike të portës, tjetri sugjeronte se ishte më e leverdisshme të shkruanin një parrullë tjetër në përmasa më të vogla. Por meqënëse si për variantin e parë, ashtu edhe për të dytin, koha nuk premtonte, vendosën ta vinin ashtu siç e kishte bërë ustai. Kur ata e vendosën atë alamet parrulle dhe po sodisnin frutet e punës së tyre, u duk toger Jahja që po nisej të delte nga reparti.



— Ç'bëni këtu, rebelë? — iu kanos dy ushtarëve.

— Punën e ngarkuar e mbaruam, zoti toger! — raportoi ushtar Vata. — Bezja e shkruar u vendos në vendin ku na udhëzoi zotnia e tij, nëntoger Estrefi.

Togeri i hodhi një vështrim të zymtë parrullës dhe përveshi buzët.

— Po pse, parrullë është kjo. more! Mos e kenë vendosur aty për të trëmbur serrat, gomerë? Edhe kur vdiq nëna mbretëreshë nuk është vendosur një parrullë më ogurzezë se kjo! Hiqeni shpejt këtë beze të zezë që ndjell tersllëk dhe të vendoset një tjetër me ngjyra të hapura! — urdhëroi pastaj prerë dhe u largua.

Panë, ç'panë, dy ushtarët e hoqën atë parrullë që e kishin vënë me aq mund e sakrificë dhe me të nën sjetull u drejtuan për te pikturisti. Si kaloi njëfarë kohe, parrulla e dytë u bë gati. Ishte alamet parrulle, sfondi i bardhë i të cilës shkëlqente prej disa dhjetra metra larg. Mbi të mezi të zinte syri ca shkronja të shkruara me bojë të verdhë. Parrulla e dytë u vendos. Ushtarët mbaruam punë dhe vendosën të largoheshin. Nuk kishin bërë veçse pak hapa, kur nga pas dëgjuan zërin e çjerrë të nëntoger Estrefit:

— Ç'është gjithë ai çarçaf që kini vënë mbi portë për t'u tharë, bre horra!

Ushtarët i shpjeguan se nuk ishte çarçaf, por beze e shkruar për inspektorat. . .

— Për inspektorat? E ç'është ajo, bre iu vraftë allahu! Hiqeni, more shpejt, se po e gjeti aty major Beshi, ju piu e zeza!

Dulla dhe Vata u kacavjerën edhe një herë dhe

e hoqën edhe atë parrullë. Ia dorëzuan nëntogerit, i cili, si e palosi mirë e bukur, e fundosi në xhepin e tij.

— Të shkruhet në mënyrën më urgjente një beze tjetër, hajde!

Ushtar Dulla mori guximin t'i thoshte se pikuristi nuk do t'u shkruante më tjetër beze, pasi edhe të dytën e kishte shkruar me njëmijë e një të shara. Nëntogeri urdhëroi menjëherë kapter Kaleshin që të bisedonte dhe një herë me pikturistin. Kapteri sëç murmuriti vesh më vesh me ustanë dhe gjithëçka u rregullua më së miri. Gjersa të shkruhej parrulla për së treti, dy ushtarët, për mos t'u vajtur koha dëm, vendosën të merreshin me vendosjen e surratit të Lartmadhërisë së Tij. Filluan të diskutonin me se ta lidhnin Lartmadhërinë: me një copë gjalmë, apo me tel. Kur panë se portreti rëndonte si të ishte prej plumbi, i dhanë karar ta varnin me një copë tel. Mirëpo, do ti? Sapo ata vendosën portretin, një zog u ul të pushonte mbi të.

— Shiko, Dullë, më qafsh! — qeshi Vata që e pa i pari, — Zogu ka hipur mbi Zogun!

Të dy ia dhanë të qeshurit me të madhe. Në këtë gaz të shfrenuar i gjeti kapter Kaleshi.

— Ç'më qeshni kështu si hajvanët, more? — iu tha atyre i zemëruar.

— Me atë zogun, zotni kapter Kaleshi! — mori menjëherë drejtqëndrim ushtar Vata dhe pastaj zgjati gishtin drejt portretit të Lartmadhërisë, mbi të cilin kishte qëndruar zogu fluturues. Në këtë çast, si t'ua kishte bërë me qëllim, zogu hapi krahët dhe u largua menjëherë. Kapter Kaleshi ngriti sytë andej nga u drejtua dora e ushtarit dhe, kur sytë i ndeshën në surratin e Ahmet Zogut, nderoi vetë-



timthi me sy të çakërritur nga ajo që i panë sytë dhe i dëgjuan veshët.

— Rebelë! — ulëriti si e mori veten nga ajo tronditje. — Edhe ju, rreckamanë, u bëtë për të hapur dhëmbët me Lartmadhërinë e Tij! Para kriminelë!

I vuri përpara dy ushtarët dhe shkoi e u fut drejt e në zyrën e major Beshit. Deponimi i kapter Kaleshit sikur ia zgjoi mendjen majorit. Deponimin e kapterit, majori e çmoi shumë lart. Ndofta atij i kishte rënë në dorë fija e ndojnë atentati kundër mbretit, nga i cili, kapteri do të merrte në dorë patjetër udhëheqjen e repartit, kurse ai, Beshi, ndojnë post me rëndësi në Ministrinë e Luftës. Dy nga pjestarët e një grupi të rrezikshëm për pushtetin e mbretit, bile edhe për jetën e tij, kishin rënë në grackë.

I gjendur para këtij deponimi të rëndësishëm, s'kishte nevojë për asnjë deponim të mëtejshëm. Beshi urdhëroi që të dy rebelët të lidheshin mirë e mirë dhe të niseshin drejt xhandarmërisë. Prej andej, të përcilleshin menjëherë në drejtim të kryeqytetit, të siguruar me roje të forta e besnike, për faje të rënda politike.

## KREU X

Në ditën e katërt të përgatitjeve, qysh herët në mëngjez, nëpër Zeren filluan të dukeshin disa ushtarë të ngarkuar me sende nga më të ndryshmet. Një pjesë prej tyre mbanin në duar shporta të mbushura me vezë, të tjerë mbanin kokëposhtë pula e gjela, të cilët, meqë mëngjezi i kishte zënë në qytet, sipas zakonit, ia filluan koncertit të tyre, duke alarmuar kështu gjithë qytetin sa një grusht. Nja dy a tre nga ushtarët kishin vënë çantat e shpinës mbi kurrriz. Po t'i hapje ato çanta, brenda në to nuk do të gjeje pajimet ushtarake personale po gjalpë, pula të rjepura që prisnin të futeshin në tavë, raki... gjer edhe turshi. Ishte dita e fundit e përgatitjeve, dita e kthimit të ushtarëve që kishin dërguar të furnizoheshin pranë familjeve të tyre për shtrimin e gostisë së madhe me rastin e inspektimit.

Me sa dukeshin bathët, gjithçka po vente mirë e bukur në ditën e fundit të përgatitjeve. Këtë e tregonte më së miri dyndja e ushtarëve të «armatosur» që shkonin drejt repartit ushtarak. Një tetar, me nja gjashtë pula në duar po ecte trokthi përmes Zerenit. Me sa dukej ishte më i vonuari. Nga dyn-



djet, pulat kakarisnin me sa kishin në kokë. Nga një zhurmë e tillë, major Beshi, tërë nerva, doli në dritaren e shtëpisë së tij. Kur vërejti se aty pranë po kalonte një tetar nga të tijtë, ia bëri me dorë që të futej në shtëpi. Nuk kaloi shumë dhe tetari, doli që andej me tri pula mangut në dorë dhe me qortimin e major Beshit në tru, i cili i kishte tërhequr vërejtjen se kishte ulur figurën morale të ushtrisë mbretërore me ato pula në duar. Pikërisht për këtë arsye majori i kishte mbajtur tri nga të gjashtë pulat, në shtëpi të tij.

Tek postbloku i repartit ishin grumbulluar të gjithë ushtarët e kthyer atë ditë nga familjet. Centralist Sala kishte hapur një listë dhe herë pas here thërriste nga një emër, ndërsa kapter Kaleshi mërrrej me kontrollin e cilësisë së asortimenteve që sapo kishin arritur.

— Ejup Quka! — thirri fort Salë centralisti.

Nga turma u shkëput një ushtar dhe filloi të raportonte:

— Zotni kapter Kaleshi, ushtar Quka u kthye nga leja e jashtëzakonshme me një kile raki rrushi, safi, ballë kazani!

— Pak, rrezil, pak! — tundi kokën kapteri dhe si për lau shishen nga dora e ushtarit, i hoqi tapën. Futi grykën e shishes në gojë dhe, si tërhoqi disa gllënjka, përplasi gjuhën gjithë kënaqësi.

— Kapllan Shiti! — vazhdoi sipas listës Sala.

— Zotni kapter, raportoj se solla për Lartmadhërinë një shportë me vezë!

— Mbaj gojën rrezil! — iu vërsul kapteri. — Nuk i ke sjellë për Lartmadhërinë, se nuk ka mbetur Lartmadhëria të ushqehet me vezët e tua, more.



vesh? — Dhe, si i hoqi shportën nga dora, e urdhëroi të kalonte matanë.

— Rushit Lusha! — vazhdoi më tej Sala.

Nga grumbulli i ushtarëve u shkëput një ushtar i vogël, i imët, i cili që fundosur i tëri në uniformë.

— Raporto! — e urdhëroi kapter Kaleshi.

— Zotni kapter, raportoj se një ditë para se të shkoja unë, në shtëpi kishte vajtur taksidari, kish-te përparë me ç'kishte gjetur dhe nuk na kishte lënë gjë prej gjëje në shtëpi.

Si mbaroi dorëzimi i ushqimeve, i erdhi radha kuzhinës që të fillonte nga puna. Filloi skuqja e vezëve, pjekja e pulave, pregatitja e turli gjellëve e mezeve, era gudulitëse e të cilave tërhoqi pas gjithë zagarët ku ishin e ku s'ishin.



Pasdite vonë, major Beshit i ra në dorë edhe një fonogram tjetër nga ministria. Në fonogram shkruhej:

«TEPËR SEKRET PIKË MAJOR BESHIT  
NË DORË PIKË DUKE FILLUAR NGA  
MOMENTI KUR DO TË MERRET KY  
FONOGRAM ASNJË USHTAR MOS LE-  
JOHET TË DALË NGA TERRITORI I  
REPARTIT PIKË I GJITHË ARMATIMI TË  
SIGUROHET MË SË MIRI NË NJË MA-  
GAZINË TË SIGURTË DHE TË KYÇEN  
ATY PIKË ÇELËSAT T'I DORËZOHEN  
TOGER JAHJES I CILI BRENDA NATËS  
DUHET TË NDODHET PATJETËR NË TI-  
RANË PIKË ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME  
MBRETËRORE PIKË.

Firmosur: KOLONEL DAUTI

Derisa fonogramet po vinin varg njëri pas tjetrit, domethënë se Beshi përsëri kishte fituar konsideratën e eprorëve të tij andej nga ministria. I kënaqur nga një gjë e tillë, filloi të vinte në zbatim urdhërat e marra. Në mbrëmje vonë, kur armët e ushtarëve u kyçën me siguri të plotë në një vend që vetëm ai dhe togeri e dinin, majori ia dorëzoi çelësat Jahjes, i cili pa humbur kohë u nis në drejtim të kryeqytetit.

Afër mesit të natës, major Beshi, i lodhur e i këputur pas tërë atyre telasheve, shkoi të flinte. Duke e ndjerë përgjegjësinë e tij për ato përgatitje të

ethëshme, majori i kishte ndenjur mbi kokë kuzhinerit, që të provonte me gojën e tij gjellët e pregatitura. Kjo ishte e vetmja ditë që kishte kaluar pa ndonjë të papritur. Bile ishte një ditë që i kishte vënë në lëvizje edhe zotërinjtë e ministrisë. Ata me siguri që kishin marrë vesh për zbulimin e dy ushtarëve rebelë në repartin e major Beshit, dhe, për më të sigurt, kishin thirrur për hetime nipin e kolonel Dautit. Vetëm një diçkaje nuk po i binte në të Beshi. Përse vallë e kishin urdhëruar që armët e ushtarëve të kyçeshin me siguri të plotë dhe çelësat t'i dorëzoheshin togër Jahjes? Mos me të vërtetë ishte kapur filli i një grupi të rrezikshëm që vinte në rrezik pushtetin absolut të Lartmadhëris së TIJ?

Me këtë pyetje në kokë, dhe me barkun e mbushur, dëng, Beshi mbështeti kokën mbi gjoksin e mbushur të Lulushe hanëmit, dhe sakaqë filloi të gërhasë.



## KREU XI

Si për dreq, data tetë, dita e pritjes së zotërinjve të inspektimit, gdhiu gjithë shi. Kjo gjë sikuria prishi humorin major Beshit. Meqënëse kishte rënë të flinte pas mesit të natës, gjumi i doli shumë vonë. Vetja i dukej i qullur si asnjëherë tjetër. Kishte bërë një gjumë të sëkëlldisur. Si nëpër gjumë e kishte shqetësuar një zhurmë uturitëse që i dukej sa vinte nga qielli. Si u ngrit gjithë përtesë nga shtrati, u rrua, veshi kostumin e tij më të mirë ushtarak dhe doli në rrugë.

Për çudi rrugët e Zerenit zienin. Banorët e tij ishin mbledhur trumba-trumba dhe seç çuqurisnin me fytyra të trembura e të revoltuara. Major Beshi i dha karar se do të ishte më mirë që mos t'u binte në sy atyre. Në qytet do kishte ndodhur patjetër ndonjë vdekje. Kur iu afrua repartit, vuri re se porta kryesore ishte bllokuar nga një numër i madh njerëzish që thërrisnin me sa u hante zëri. Kur pa në major Beshin, u vërsulën drejt tij dhe sakaq ai e pa veten të rrethuar prej tyre.

— Tradhëtarë! — thirri me të madhe një zë bubullitës, — Ku i keni armët?

— Armë! Armë! Duam armë! — u bashkuan me të qindra zëra.

— Armë! Duam armët! — dëgjoi Beshi që nga reparti dhe vështroi andej.

U habit dhe u tmerrua nga skena që i panë sytë. Një pjesë e mirë e ushtarëve po mundoheshin të shpartallonin derën e magazinës ushqimore, ku Beshi kishte kyçur armët. Ushtarët qëllonin me shqelma mbi derë dhe thërrisnin me të madhe. Pastaj dalloj se tre a katër ushtarë filluan të kacavirreshin në shtyllën e telefonit që ishte ngjitur me magazinën e sakaq u gjendën majë saj.

Kapter Kaleshi çirrej e ngjirrej me sa i hante gurmazi, po askush nuk ia vinte veshin. Kur vuri re se ushtarët u ngjitën në majë të çatisë, edhe kapter Kaleshi, me shumë mundime, filloi t'i ngjitej shtyllës së telefonit. Dy herë iu ngjit asaj pothuajse në krye, por duart s'i mbanin dhe lëshohej përsëri, duke rrëshqitur nëpër shtyllë. Më në fund u ngjit dhe kaloi mbi çatinë e magazinës për t'u futur që andej në magazinë. U drejtua nga ata dhe kapi njërin syresh nga jaka e xhakëtës. Ushtari u ngrit menjëherë dhe si dalloj se kush ishte, i dha një të shtyrë. Kapter Kaleshi humbi drejtpeshimin dhe u lëshua si ndonjë thes me miell nga çatia në tokë.

Beshi që po shikonte këtë skenë, bëri të ecte andej, kur ushtarët, që ende qëllonin me shqelma mbi derë, e dalluan dhe iu vërsulën:

— Armët! Duam armët! Çelësat e armëve! Tra-dhëtarë!

Major Beshi u mundua të hapte gojën e t'u shpjegonte se çelësat i kishte marrë me vete toger Jahja në Tiranë, por goja nuk po i komandohej, si



të ishte ngjitur me tutkallë. Nuk e kuptoi as vetë se si u shkëput prej tyre dhe si u fut me vrap në ndërtesën e komandës.

— Ç'bëhet kështu, more? — iu hakërrua nëntoger Estrefit, i cili ishte mbledhur kruspull në një qoshe të korridorit.

— S'merret vesh, zotni major, — foli ai me frikë, duke u munduar të merrte qëndrimin gatitu. — Presim miqtë nga Italia e madhe. Kështu tha zoti nënprefekt, që ndodhet në zyrën tuaj në pritje të miqve!

Major Beshi u drejtua nga zyra e tij dhe u fut brenda.

Nënprefekti dhe rrethkomandanti i xhandarmërisë, me tavolinën mbushur me njëqind të mira, ia kishin shtruar për shtatë palë qejfe.

— Hajde, major, hajde! Le ta pimë këtë gotë për miqtë tanë të ndritur, për Italinë e madhe! — iu drejtua buzagaz nënprefekti dhe ngriti gotën i pari.


— Do të na vrasë populli! — ulëriti me sy të çakërdisur major Beshi.

— Mos u tremb, mos u tremb! — e qetësoi nënprefekti, — miqtë tanë nga minuta në minutë do të jenë këtu. Pini një gotë të qetësoheni. . . I kam marrë të gjitha masat unë.

Në këto çaste ia behu nëntoger Estrefi duke thirrur:

— Erdhi, zotërinj! . . erdhi ai. . . inspektimi.

Gotat u përplasën me tërsëllëm dhe të tre u dhanë në të njëjtën kohë te dera. Të tre trupat e tyre luftuan një copë herë se kush do të delte i pari. Si më i shkurtër e më i zhdërvjelltë, në këtë mes përfitoi rrethkomandanti i xhandarmërisë.



Shiu vazhdonte të binte edhe më me rrëmbim. Tej, nëpër atë mjegull të dëndur që ishte derdhur anekënd, ata dalluan një veturë të zezë si korbi dhe disa maqina që e ndiqnin nga pas. Zhurma e tyre trondiste gjithë Zerenin.

Ushtarët, të cilët më së fundi kishin mundur ta shqyenin magazinën, po shpërndaheshin me pushkë në duar në pika të ndryshme të repartit.

Vetura e zezë dhe maqinat u afruan tek porta kryesore e repartit dhe aty ndaluan. Nga vetura doli një oficer i gjatë e i hollë. Me të tundra e gjithë naze ai e nguli vështrimin e tij mbi portretin hijerëndë të Lartmadhërisë, që nusëronte majë portës. Pastaj seç i foli një oficeri që i qëndronte përkrah dhe, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, nga maqina e parë u sulën tre ushtarë me helmata në kokë. U ndalën



nën portë, fomuan një shkallë me kurrizet e tyre dhe sakaq e përplasën përtokë portretin, që përfundoi përmbys në një pellg gjithë llucë, si t'i kishte filluar një dhembje e fortë barku. Nënprefekti e ndiqte buzagaz këtë skenë, ndërsa major Beshi çakarriste sytë. Në pak sekonda, në vend të surratit të Lartmadhërisë së Tij, mbretit, u vendos një surrat tjetër. Një burrë i tmerrshëm, me sytë e kërcyer si dy kokrra vezë dhe me një kokë klasike, sa të fuste lemerinë.

Viva il Duçe!<sup>1)</sup> — thirri fort oficeri i gjatë, i cili, në krahasim me trupin e tij të hollë, kishte një zë të tmerrshëm.

Viva! — iu përgjegjën qindra helmeta, që lëvizën nga vendet nëpër maqina, prej ku, për çudi, u zgjatën drejt qiellit qindra palë duar.

Viva! — nuk iu ndenj pa thirrur edhe nënprefektit.

Vvvvvviva! — belbëzoi me të marrura goje rrethkomandanti i xhandarmërisë.

— Avanti!<sup>2)</sup> — thirri përsëri oficeri i hollë, dhe i kënaqur sa s'bëhej i futi krahun nënprefektit Të dy u fundosën në kolltukun e veturës luksoze, e cila filloi të rrëshqiste drejt qëndrës së reparitit.

Major Beshi mbeti si i ngrirë. I dukej sikur ishte në ëndërr. «Ne kishim Ministri Lufte,» mendoj ai, «ku është ajo ministri? Po ai Lartmadhëri?» Vargu i maqinave kaloi tërë zhurmë e rrapëllimë pranë këmbëve të tij. Kur po kalonte maqina e fundit, rrethkomandanti i xhandarmërisë, duke menduar

---

1) Rroftë Duçja!

2) Përpara!

se nënprefekti hileqar ua kishte hedhur, u kacavjerr me të dy duart pas spondit të saj.

Beshi vështronte si i trullosur ato vraga të thella që kishin lënë maqinat mbi baltë. Kërkoj me sy të shikonte edhe njëherë surratin e Lartmadhërisë së Tij e të çmallej me të, por ai ishte fundosur thellë në baltë dhe s'i gjendej as nami as nishani.

— Në djall të vesh! — e mallkoi Lartmadhërinë dhe brofi të zinte vendin e tij pranë oficerit të Duçes, i cili ndofta nuk e dinte që ishte edhe ai në Zeren, prandaj edhe nuk e kishte sajdisur fare.

Populli i grumbulluar sërish para portës, thërriste:

— Tradhëtarë, Armët, ku i keni armët!

Diku brenda repartit u dëgjuan të shtëna pushkësh. Vetura dhe vargu i maqinave qëndruan menjëherë. Qindra helmeta lëvizën nga maqinat dhe u shndërruan në ushtarë, që filluan të përhapeshin me shpejtësi nëpër tërë territorin e repartit. Të shtënat e pushkëve u bënë më të shpeshta...

Ishte mëngjez. Një mëngjez gjithë mjegull, shi. llucë... «Inspektimi» i Lartmadhërisë së Tij, «shkatërrimtarit të mëmëdheut», kishte arritur në Zeren tamam në atë mëngjez të tetë prillit 1939...